



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**



Z. Ilir MURTEZI  
Pronar  
RTV Iliria  
N.SH. ILIRI  
Nr. i biznesit 71001741  
R006&T015  
Viti  
Komuna e Vitisë

Ref: 1404/528/KPM/ni

Z. Kadrush MURTEZI  
Kandidati i propozuar për pronar  
N.SH. "ILIRI"  
Nr. i biznesit 71001741  
Viti  
Komuna e Vitisë

### VENDIM

*lidhur me ndryshimin e personit fizik të N.SH. ILIRI - Radio Televizioni Iliria – Viti  
Komuna e Vitisë*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Televizioni Iliria (RTV Iliria) është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio dhe TV programe në komunën e Vitisë. RTV Iliria është pajisur nga KPM, me licencë afatgjatë të transmetimit me datën 30 tetor 2009.
3. Me datën 17 dhjetor 2013, RTV Iliria ka dorëzuar në zyrën e KPM-së, një kërkesë për ndryshimin e personit fizik të pronësisë së Radio dhe TV stacionit përmes së cilës është kërkuar që në vend të pronarit aktual z. Ilir Murtezi si person fizik të caktohet z. Kadrush Murtezi.

4. Në bazë të udhëzimit të KPM-së për plotësim të kërkesës me dokumentet përkatëse, kandidati me datën 29 maj 2014, ka dorëzuar dokumentet e kërkuara dhe ka plotësuar kërkesën e tij.
5. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë së RTV Iliria thuhet se, arsyeja për ndryshimin e pronësisë është oferta për angazhimin e z. Ilir Murtezi në një subjekt politik në cilësinë e këshilltarit për media.
6. Në kërkesën e parashtruar, përveç ndryshimit të pronësisë – personi fizik - nuk do të ketë ndryshime në parametrat teknike dhe në skemën programore sipas licencës së RTV Iliria.
7. Personi fizik i propozuar për pronarë të ri të RTV Iliria ka deklaruar se do të menaxhojë dhe do të zhvillojë RTV Iliria duke investuar edhe në teknologjinë moderne.

### Arsyetimi

8. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
9. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
10. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
11. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t'i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t'iu dhënë një licencë.”*
12. Prandaj, në pajtim me nenin 15.4 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, KPM, konkludon se kandidatit të propozuar për pronar t'i transferohet licenca, i përmbush kriteret dhe standardet e kualifikimit për licencë të KPM-së.
13. Arsyetimin për bartje të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik, duke marrë parasysh se nuk do të ketë ndërrime të theksuara në skemën programore dhe në strukturën organizative të RTV Iliria.
14. KPM, vlerëson se ndryshimi i pronësisë së RTV Iliria nuk do të ndikojë në ndryshimin e formatit të programit dhe zonës së mbulimit të këtij subjekti transmetues.

## VENDIM

15. KPM merrë vendim për ndryshimin e personit fizik të pronësisë së RTV Iliria nga z. Ilir Murtezi duke e pranuar personin fizik z. Kadrush Murtezi si pronar të ri të biznesit me emrin N.SH. "ILIRI" duke i bërë ndryshimet në certifikatën e regjistrimit të biznesit.

### Lëshimi i Vendimit

16. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tijë.

  
Adnan MEROVCI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave

11.06.2014  
datë